

Kompania: AFAM Group ® Sh.p.k.

Titulli/Pozita: Tre (3) Praktikant/e me mundësi punësimi - Teknik i kontabilitetit

Departamenti: Tatime dhe Kontabilitet

Vendi/Lokacioni: Prishtinë

Bashkëpunon me:

Stafin e AFAM Group dhe i përgjigjet personit udhëheqës të ekipit

Detyrat dhe përgjegjësit:

Tekniku i kontabilitetit do të kontriboj në zbatimin e detyrave të caktuara nga udhëheqësi i ekipit sipas procedurave dhe politikave të brendshme të Kompanisë, si dhe duke u bazuar në praktikën më të mirë të kryerjes së punës. Ky rol do të kërkojë shfrytëzim të madh të njohurive kontabël, menaxhim të mirë të kohës, përshtatje të shpejtë në ambientet e reja të punës dhe zgjidhje efektive të problemeve që sigurojnë sukses.

Përgjegjësitë direkte:

- Kalkulimi dhe përgatitja e listës së pagave, kontrollimi i saj me shënimet mbështetëse kontabël
- Përgatitja e librave tregtar, konfirmimi i tyre me dokumentacion mbështetës si dhe raportimi i çështjeve me rendësi tek udhëheqësi i ekipit
- Kalkulimi dhe përgatitja e deklarimeve për qira, interes, dhe tatime tjera direkte. Informimi i udhëheqësit të ekipit në lidhje me çështjet me rendësi
- Krijimin e raporteve të ndryshme sipas kërkesës së udhëheqësit të ekipit
- Ndihma në punët kontabël të mbylljes së muajit dhe mbylljes së vitit
- Mbështetje në punët administrative

Edukimi dhe kërkesat tjera profesionale:

- Diploma Bachelor (Financa & Kontabilitet) – (ose në përfundim të studimeve)
- SCAAK – niveli i parë (dëshmitë e ofruara do jenë përparë)
- Njohja e Gjuhës Angleze (dëshmitë e ofruara do jenë përparësi)
- Njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit, me theks të veçantë Excel, Word, Power Point etj (dëshmitë e ofruara do jenë përparësi)
- Njohuri të mira në punën me softweret kontabël
- Njohuri të mira mbi ligjet e tatimeve dhe procedurave tatimore në Kosovë
- Aftësi të avancuara të komunikimit verbal dhe përmes e-mailit
- Aftësi për të punuar vetëm dhe në ambientet e punës në grup
- Aftësi të mira të prezantimit të kompanisë tek klientët

Cilësi personale:

- Të jetë i besueshëm dhe i drejtë
- Të jetë i respektueshëm dhe i sjellshëm
- Të jetë fleksibil
- Të ketë kulturë dhe qasje të mirë ndaj personave me të cilët punon

Ju lutem na i dërgoni CV-të tuaja në e-mail adresën : info@afamgroup-ks.com jo më shumë se një herë dhe gjithashtu tek rubrika “subject” të ceket emri mbiemri dhe pozita e kandidatit në të cilën konkuron.

Praktika do të zgjat tre muaj ndërsa në fund të kësaj periudhe do të bëhet vlerësimi i kandidatëve për vazhdimin e marrëdhënieve të rregullta të punës.

Konkursi do të jetë i hapur deri më datë 09/06/2019.

CV-të e pranuar pas kësaj date nuk do të mirren në konsiderat.

Vetëm personat të cilët do të për zgjedhen për testim do të kontaktohen.